



MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 127, dt. 03.07.2015

Në mbështetje të ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 03.07.2015, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, lidhur me punimet shtesë që do të realizohen gjatë restaurimit të kishës së Shën Thanasit, Karavasta, Lushnje,

VENDOSI:

1. Projekti të plotësohet me vërejtjet e mëposhtme dhe të rishqyrtohet në mbledhjen e radhës së KKR:
 - Lidhur me ndërhyrjen në sistemimin e territorit përreth kishës të vendoset kusetë për disiplinimin e ujërave përreth territorit të saj.
 - Të sillen propozimet për llojin e shtrimit të dyshemesë së hajatit të kishës.
 - Të sillet i detajuar projekti i ndërhyrjes së përforcimit të këmbanares së kishës.
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

